



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 603E/ Prot.
18e

Tiranë, më 03.12.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje me dyer të mbyllura)

(Mbajtur, më 19.10.2020)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. [] (shtyrë nga mbledhja e datës 28.09.2020).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:35 dhe mbaroi në orën 14:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 19.10.2020 (Pika 9)



Shënim: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro* si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Fatmira Luli*.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. [] (shtyrë nga mbledhja e datës 28.09.2020).

Përpara se të fillojë çështja e rendit të ditës, anëtarët bëjnë një diskutim në parim lidhur me dorëheqjen e një anëtarit, kjo pasi nga ana e Kryetares së Këshillit është miratuar kërkesa e anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Fatmira Luli*, për mospjesëmarrje në shqyrtimin e çështjes “Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. [] për pozicionin në lirë në Gjykatën e Lartë”, duke konsideruar kështu të drejta arsyet, ndërkohë që ky vendimi bëhet pjesë e dosjes së kandidatit.

Mbi këtë diskutim, e para merr fjalën *zonja Kadi* e cila shprehet se kur është draftuar rregullorja e brendshme e Këshillit, pjesa lidhur me konfliktin e interesit është diskutuar gjatë, kjo pasi ka momente kur anëtari thjesht deklaroi dhe ikën e nuk merr pjesë në shqyrtimin e çështjes pa vendimarrje të Kryetarit, ndërkohë ka edhe momente kur kërkon vendimarrjen e Kryetarit.

Lidhur me mospjesëmarrjen e zonjës *Luli*, zoti *Toska* thekson se zonja *Luli* parashtrroi kërkesë për dorëheqje dhe u shpreh që mund të dukej se ishte në konflikt interesi për shkak se bashkëshorti është në proces rivlerësimi. Sa kohë parashtrroi kërkesë, atëherë sipas ligjit, ajo u trajtua nga Kryetarja e Këshillit. Nëse një anëtar vlerëson se është në kushtet e konfliktit të interesit dhe vendos të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështje, atëherë kjo është një zgjedhje e tij. Në një rast të tillë, sa kohë nuk ka kërkesë për dorëheqje, nuk ka as vendim për miratimin ose jo të saj. Anëtari mban përgjegjësi për vendimin e tij për atë mënyrë zgjedhje të situatës së konfliktit të interesit, duke patur



parasysh për këtë se, si rregull, anëtarët e Këshillit kanë detyrimin të marrin pjesë në mbledhjet plenare dhe të votojnë për çështjet e rendit të ditës.

Ndërsa për zonjën Ukperaj *zonja Ukperaj* vijon atë çka tha zonja Luli, e cila është shprehur që “mos të krijohet perceptimi që bëhen favore”. Ndaj zonja Ukperaj është e mendimit që ka shumë rëndësi mënyra sesi anëtari jep arsyet e konfliktit.

Lidhur me këtë çka ka thënë zonja Luli, *zonja Shehu* i drejton një pyetje anëtarëve të tjerë lidhur me ekzistencën ose jo të perceptimit të konfliktit të interesit në dukje të anëtarëve.

Më tej *zoti Qoku* shprehet se konflikti i interesit në dukje është thjesht në dukje dhe nëse ekziston apo jo del sipas një analize. Në aspektin e arsytimit që tha zonja Luli, i bie që të gjithë anëtarët e Këshillit të jenë në konflikt në kuptimin moral.

Ndërsa *zonja Shehu* shprehet se pavarësisht situatës hipotetike që duket që ka një konflikt në dukje, për shkak të parimit të funksionalitetit, Këshilli duhet të vazhdojë. Gjithashtu zonja Shehu rikujton e-mailin e ardhur në mbledhjen e kaluar, ku një ndër pikat e vëna në dukje ishte pikërisht konflikti i interesit në dukje i të gjithë anëtarëve.

Në vijim, *zonja Kadi* thekson se nëse nuk e dinte që zonja Kadi kur ishte në procesin e rivlerësimit do të kandidonte për në Këshill dhe që do fitonte, gjithashtu nuk e dinte që do të zbrazej Gjykata e Lartë. Janë një sërë situatash.

Zoti Toska shton në fjalën e tij se, sipas tij, anëtarët gjyqtarë të Këshillit janë në konflikt interesi në dukje në çështjen e : : : sa kohë ata më parë kanë qenë subjekte në procesin e rivlerësimit kalimtar, proces në të cilin : : : ka marrë pjesë me cilësinë e Komisionerit Publik, ndërkohë që aktualisht është : : : ai që është subjekt në procedurën që po organizon Këshilli për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe ky është një fakt. Më tej thekson se ky moment ka qenë objekt diskutimi mes anëtarëve që në fillim të procedurës nga Këshilli, por në konsideratë të respektimit të parimit të

funksionalitetit, ndërsa anëtarët gjyqarë janë shumica e Këshillit, ata kanë vlerësuar të mos japin dorëheqje nga pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit për rastin e ... dhe as të zgjedhin për të mos marrë pjesë. Mospjesëmarrja e anëtarëve gjyqarë të Këshillit do të çonte në mosshqyrtimin e kërkesës së kandidimit të ..., pasi Këshilli nuk do të kishte kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve. Më pas ai shprehet se nëse vlerësohet nga anëtarët, të pasqyrohet në procesverbal që anëtarët gjyqarë të Këshillit konsiderojnë që për shkak të respektimit të parimit të funksionalitetit, ata nuk mund të heqin dorë nga ushtrimi i detyrës. Kushtetuta dhe ligji detyron Këshillin që të marrë një vendim për rastin e paraqitur përpara tij. Këshilli nuk mund t'i shmangët këtij detyrimi.

Në lidhje me këtë çështje, rimerr fjalën *zoti Qoku* i cili jep mendimin e tij lidhur me konfliktin e interesit në dukje, i cili është një nga llojet e konfliktit të interesit dhe që është vetëm në dukje dhe që në fakt nuk ekziston. Këshilli nuk e ka këtë vendimmarrje që ai të përfitojë sepse Këshilli është një organ kolegjal dhe ka pavarësi në vendimmarrje bën që ky konflikt thjesht të duket, por nuk ekziston.

Pas këtij diskutimi në parim, zoti Toska i cili është relator i kësaj çështjeje të rendit të ditës parashtron relacionin shtesë "Mbi dokumentet e paraqitura rishtazi në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatën e lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit ...".

Relacioni si më poshtë:

"Ky Relacion Shtesë është përgatitur në vijim të vendimmarrjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, në Mbledhjen Plenare të datës 28.09.2020, për shtyrjen e shqyrtimit e rezultateve të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të ..., për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.172, datë 11.09.2019, me qëllim për t'i dhënë kohën e nevojshme relatorit zëvendësues për të përgatitur një relacion shtesë në lidhje me dokumentacionin e administruar rishtazi gjatë procedurës së verifikimit, si dhe për të marrë, në kuadër të kësaj procedure, informacione dhe dokumente nga disa subjekte publike.

Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 19.10.2020 (Pika 9)

Relacioni për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit : , përgatitur nga relatori i mëparshëm, z. Toro, iu nënshtrua shqyrtimit në Këshill, në Mbledhjen Plenare të datës 16.01.2020. Në këtë Mbledhje, pasi relatori prezantoi procedurën e verifikimit si dhe rezultatet e verifikimit të kushteve të kandidimit/emërimit si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit : , nga ana e anëtarëve të Këshillit, u parashtruan pyetje të ndryshme në lidhje me disa çështje që ishin verifikuar gjatë procedurës. Në përfundim të diskutimit, Këshilli vendosi plotësimin e dokumentacionit të procedurës së verifikimit nga ana e kandidatit .

Konkretisht, në Mbledhjen Plenare të datës 16.01.2020, referuar Procesverbalit të Mbledhjes - Faqet 26 dhe 30, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur që kandidatit : t'i kërkohet plotësimi i dokumentacionit si vijon:

- 1) Konfirmimi nga Dhoma e Avokatisë greke në lidhje me ushtrimin e shërbimit të avokatisë pranë avokatit në Greqi;
- 2) Përkthimi i ligjit grek për të kuptuar meqenëse mund të vihet në diskutim interpretimi i qenies së kandidatit asistent avokat dhe a mund të konsiderohet avokat në kuptim të ligjit shqiptar;
- 3) Konfirmim nga universiteti grek në lidhje me asistent pedagogun dhe çfarë ka bërë në fakt, a ka qenë lektor i së drejtës në kuptim të ligjit shqiptar;
- 4) Konfirmim zyrtar nga universiteti në Zvicër në lidhje me veprimtarinë si kërkues shkencor të kandidatit.

Për këtë, nga ana e relatorit të çështjes, z.Toro, në rrugë elektronike, më datë 17.01.2020, kandidatit iu dërgua njoftimi për plotësimin e dokumentacionit në lidhje me kushtet dhe kriteret e kandidimit, e më konkretisht:

1. Konfirmim nga autoriteti kompetent i Republikës së Greqisë për ushtrimin e profesionit të avokatit të , si dhe për kohën e ushtrimit nga ai të këtij profesioni.
2. Konfirmim nga autoriteti kompetent i Republikës së Greqisë për llojin e aktivitetit të kandidatit pranë Zyrës së Avokatit , si dhe për kohën e këtij aktiviteti.

Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 19.10.2020 (Pika 9)



3. Konfirmim nga [] për aktivitetet konkrete të kryera nga kandidati pranë kësaj zyre, si dhe nëse ato janë kryer ose jo kundrejt pagesës.

4. Konfirmim nga [] për aktivitetin e kandidatit pranë këtij [], natyrën dhe kohën e tij.

5. Konfirmim nga [] për [] për aktivitetin e kandidatit pranë këtij [], natyrën dhe kohën e tij.

Në njoftimin elektronik të datës 17.01.2020, përveç sa sipër, relatori i ka kërkuar kandidatit [] që të kishte në vëmendje faktin që aktet dokumentare, për konfirmimet si më lart nga autoritetet e huaja, duhet të ishin të certifikuara sipas Konventës së Hagës "Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja" të 5 tetorit 1961, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Kandidati [], nëpërmjet një "Letër Sqaruese", të datës 10.02.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 5045/2 prot., datë 10.02.2020, depozitoi dokumentet si më poshtë:

1. "Vërtetim" datë 27.01.2020, lëshuar nga [] ([]). Dokumenti origjinal në gjuhën greke mban vulën apostile. Është përkthyer në gjuhën shqipe sipas Kodit për Avokatinë të Republikës Helene, neni 36, para 2c. Avokati që përktheu [], firmosur dhe vulosur prej tij. Dokumenti nuk është i noterizuar;

2. "Vërtetim" datë 05.02.2020, lëshuar nga [], drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë. Ky dokument mban vulën e vërtetimit të origjinalitetit të firmës së [], e vulosur prej Kryetarit të Dhomës së Avokatisë Athinë. Dokumenti origjinal në gjuhën greke mbart vulën apostile. Është përkthyer në gjuhën shqipe sipas Kodit për Avokatinë të Republikës Helene, neni 36, para 2c. Avokati që përktheu [], firmosur dhe vulosur prej tij. Dokumenti nuk është i noterizuar;

3. "Vërtetim" [], datë 28.01.2020, lëshuar nga Drejtoria e Çështjeve Arsimore dhe Kulturore, Ministria e Jashtme. Dokumenti mbart firmën e

Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 19.10.2020 (Pika 9)

6



nëpunësit përgjegjës : dhe vulën zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Helene. Dokumenti origjinal është në gjuhën greke. Ai është përkthyer në gjuhën shqipe sipas Kodit për Avokatinë të Republikës Helene, neni 36, para 2c. Avokati që përktheu :,

firmosur dhe vulosur prej tij. Dokumenti nuk është i noterizuar;

4. “Vërtetim” datë 18.07.2013, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë dhe i Shkencave Ekonomike dhe Politike, Universiteti Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës. Dokumenti mbart firmën e profesor: dhe vulën zyrtare të Universitetit.

Dokument origjinal mbart vulën apostile. Ai është përkthyer në gjuhën shqipe sipas Kodit për Avokatinë të Republikës Helene, neni 36, para 2c. Avokati që përktheu :, firmosur dhe vulosur

prej tij. Dokumenti nuk është i noterizuar;

5. Dokumente që konfirmojnë përzgjedhjen e kandidatit për burse ekselence, komunikime në formë shkresore dhe elektronike të datave 22.04.2013 dhe 01.05.2013, në gjuhën gjermane dhe angleze e më konkretisht:

- Dokument në gjuhën gjermane (që është një nga gjuhët zyrtare në Zvicër) dhe angleze, i datës 22.04.2013, me lëndë: “Aplikimi juaj për një bursë ekselence të Qeverisë Zvicerane: Kandidati kryesor”. I firmosur është vetëm dokumenti në gjuhën gjermane, ndërkohë që përkthimi në gjuhën angleze është bërë nga vetë institucioni dërgues dhe është një përkthim jozyrtar (sipas shënimit);

- Dokument në gjuhën angleze i datës 01.05.2013, i kandidatit :, me lëndë: “Konfirmim: Pranimi i bursës”;

- Dokument në gjuhën gjermane dhe angleze, me lëndë “Bursa e ekselencës e Qeverisë Zvicerane”, bashkëlidhur “Udhëzimet për bartësit e bursave të qeverisë zvicerane”, “Forma e konfirmimit: Pranimi i bursës” dhe “Linqe të dobishme”.

Dokumentet në gjuhën angleze janë përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyeset interprete zyrtare dhe noterizuar nga notere

6. Dokument datë 14.12.2014, lëshuar nga Komisioni Konfederativ për Bursat, Departamenti Konfederativ i Ekonomisë, Arsimit dhe Hulumtimeve/Zvicër. Dokumenti është në gjuhën gjermane dhe mbart vulën apostile fotokopje. Është përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyeset dhe noterizuar nga notere

Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 19.10.2020 (Pika 9)



7. Dokument me lëndë "Konfirmim i qëndrimit për kërkim në ...", lëshuar më datë 26 janar 2020, nga ... gjatë dy viteve", lëshuar më datë 26 janar 2020, nga ... Dokumenti është në gjuhën angleze dhe mbart vulën apostile fotokopje. Është përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes interpretë zyrtarë ... dhe noterizuar nga notere ...

8. Kopje në letër e dokumenteve elektronikë që përmbajnë informacion të përgjithshëm për programin e studimit Bachelor në ... si dhe për publikimin e temës së doktoraturës e të dhëna në lidhje me të, të cilët janë publikime në faqen zyrtare elektronike të ... Dokumentet origjinale janë në gjuhën greke. Përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyesi zyrtar ... dhe noterizuar nga notere ...

9. Kopje në letër e dokumentit elektronik që përmban renditjen e Universiteteve Botërore për vitin 2020, aksesuar në adresën ... Botim në gjuhën angleze, përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes ... dhe noterizuar nga notere ...

10. Kopje në letër e dokumentit elektronik - Ligji grek për avokatinë. Dokumenti është në gjuhën greke. Përkthyer në gjuhën shqipe pjesërisht nenet 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 12, 13, 14, 15, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23, nga përthyes ... dhe noterizuar nga noterë ...

Rreth përmbajtjes së dokumenteve depozituara rishtazi (më kërkesë të Këshillit) nga kandidati ...


1) Në dokumentin "Vërtetim" datë 27.01.2020, lëshuar nga ... sipas përkthimit në gjuhën shqipe, thuhet se: "... siç rezulton nga regjistrat e ... është anëtar i ... i regjistruar me ... I sipërcituari ende mbetet i regjistruar në Regjistrat e Dhomës së Avokatisë...";

2) Në dokumentin "Vërtetim" datë 05.02.2020, lëshuar nga ... drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë, sipas përkthimit në gjuhën shqipe, thuhet se: "... ka qenë i punësuar në Zyrën time të Avokatisë nga 1.10.2003 deri më 30.11.2005 në pozicionin/cilësinë e Legal Officer. Gjatë kësaj periudhe z. Sina, si i diplomuar prej Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit

Kombëtar dhe Kapodistrian ... më 2003, u punësua në Zyrën time dhe ofroi shërbime asistent avokati, duke ndihmuar në trajtimin gjyqësor dhe jashtëgjyqësor të çështjeve juridike gjithashtu edhe në ofrimin e këshillimeve juridike për persona fizike dhe ligjorë./ Në kontekstin e bashkëpunimit tonë ai bënte kërkime në legjislacione vendimeve gjyqësore dhe përgatiste fashikujt gjyqësor për mbrojtjen e çështjeve nëpër Gjykata. Gjithashtu, hartonte drafte të Padive në Gjykatat Civile dhe ato Administrative, drafte për kontrata civile dhe tregtare si dhe dokumente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative me Shtetin Grek dhe Autoritetet Administrative Greke./ Konkretisht është paraqitur me autorizim nga mua si asistent avokat ose me autorizim nga të përfaqësuarit e Zyrës time në Gjykata e Krimeve të lehta dhe në Gjykatat e Pajtimit si edhe pranë Autoriteteve Administrative dhe Shërbimeve Publike për të kryer çështjet e Zyrës time të Avokatisë. Jemi bashkëparaqitur në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe të Dytë për gjyqe të ndryshme, për të cilat ka kontribuar edhe në përpunimin ligjor dhe në dhënien e këshillave për trajtimin e këtyre çështjeve gjyqësore, si anëtar i Zyrës time...”;

3) Në dokumentin “Vërtetim” ... , datë 28.01.2020, lëshuar nga Drejtoria e Çështjeve Arsimore dhe Kulturore, Ministria e Jashtme, sipas përkthimit në gjuhën shqipe, thuhet se: “Drejtoria E1 për Çështjet Arsimore dhe Kulturore e Ministrisë së Jashtme vërteton se ... , shtetas i Shqipërisë, ka qenë bursant i saj, nga Nëntori i vitit 2005 deri më Qershor të vitit 2009, si kandidat për Doktoraturë në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Kombëtar Kapodistrian ...”;

4) Në dokumentin “Vërtetim”, datë 18.07.2013, lëshuar nga profesori ... , pranë Fakulteti i Drejtësisë dhe i Shkencave Ekonomike dhe Politike, Universiteti Kombëtar dhe Kapodistrian ... , sipas përkthimit në gjuhën shqipe, thuhet se: “E njoh ... që në kohën që ai ishte student në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Kombëtar ... s. Si student ai u dalluar për zellin e tij dhe u vlerësua me notat maksimale në lëndët e mia. Për këtë arsye, ai u pranua në katedrën time akademike si doktorant me temë të doktoraturës “E drejta e Asociimit”. Edhe në këtë nivel ... i tregoi një përgatitje shumë të lartë duke u vlerësuar me notën maksimale “Shkëlqyeshëm”. / Gjatë shkrimit të doktoraturës së tij (2005-2009) , ... ka qenë i punësuar pranë Fakulteti të Drejtësisë, në departamentit e të Drejtës Publike dhe





konkretisht në Katedrën time akademike duke më ndihmuar mua personalisht në çdo procedurë akademike. Detyrat e tij ishin supervizimi i eseve dhe mikrotezave shkencore në nivelin Bachelor dhe Master”;

5) Në dokumentet që përmbajnë komunikime të datave 22.04.2013, 01.05.2013, sipas përkthimit në gjuhën shqipe, bëhet fjalë për një aplikim të kandidatit për Bursën e Ekselencës së Qeverisë Zvicerane, për zgjedhjen e tij nga Komisioni si kandidat kryesor për vitin akademik 2013-2014, si dhe për njoftimin e kandidatit si i përzgjedhur për një bursë ekselence zvicerane për periudhën nga 16.09.2013 - 15.09.2014. Po ashtu, bëhet fjalë edhe për njoftimin kandidatit të detyrimit që kishte, ndërsa i është kërkuar të konfirmojë marrjen e bursës dhe udhëzimet për bartësit e bursave të qeverisë zvicerane;

6) Në dokumentin e datës 14.12.2014, lëshuar nga Komisioni Konfederativ për Bursat, Departamenti Konfederativ i Ekonomisë, Arsimit dhe Hulumtimeve, sipas përkthimit në gjuhën shqipe, vërtetohet se kandidati ka marrë një bursë ekselence për një qëndrim kërkimor në Universitetin e Zürichit, për periudhën shtator 2013 deri më shtator 2014;

7) Në dokumentin me lëndë “Konfirmim i qëndrimit për kërkim në Universitetin e Zürichit gjatë dy viteve”, lëshuar më datë 26 janar 2020, nga Prof. Dr. ... sipas përkthimit në gjuhën shqipe, thuhet se: “... ka bërë kërkim shkencore në Universitetin e Zürichit, gjatë dyvjeçarit. Fillimisht, ... përfundoi Bursën e Ekselencës së Qeverisë Zvicerane prej 16 shtatorit të vitit 2013 deri më 15 shtator 2014 në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Zürichit, nën mbikëqyrjen time. Deri në 15 shtator 2015, ai ka qëndruar në Universitetin e Zürichit për një tjetër vit akademik në cilësinë e kërkuesit vizitor. ...”;

8) Në dokumentet mbi informacione të përgjithshme për programin e studimit Bachelor në Fakultetin e Drejtësisë ... si dhe mbi publikimin e temës së doktoraturës e të dhëna në lidhje me të, publikuar në faqen zyrtare elektronike të Fakultetit të Drejtësisë në ..., sipas përkthimit në gjuhën shqipe, jepen të dhëna të përgjithshme në lidhje me programin e studimit Bachelor në Fakultetin e Drejtësisë ..., si dhe të dhëna në lidhje me Disertacionin e kandidatit me temë “E drejta e asociimit”, përveç edhe të dhëna të përgjithshme në lidhje me të;



9) Në dokumentin për renditjen e Universiteteve Botërore për vitin 2020, aksesuar në adresën <http://www.universityworldwide.edu/>, sipas përkthimit në gjuhën shqipe, jepen të dhëna në lidhje me renditjen e Universiteteve Botërore për vitin 2020, në të cilën Universiteti <http://www.universityworldwide.edu/> renditet i 90-të në Universitetet më të mira në botë;

10) Në dokumentin "Ligji grek për Avokatinë", pjesërisht nenet 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 12, 13, 14, 15, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23, sipas përkthimit në gjuhën shqipe, tregohet përmbajtja e këtyre dispozitave, ku jepen përcaktime të përgjithshme në lidhje me ushtrimin e funksionit të avokatit, si dhe të asistent avokatit, në shtetin grek.

Ndërkohë, sikurse më lart u përmend, në Mbledhjen Plenare të datës 28.09.2020, Këshilli vendosi të marrë në kuadër të kësaj procedure verifikimi, informacione dhe dokumente nga disa subjekte publike, e më konkretisht:

1) Materialin e administruar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në kuadër të kandidimit të kandidatit si anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;

2) Informacion në lidhje me kandidatin nga <http://www.universityworldwide.edu/> dhe <http://www.universityworldwide.edu/> dhe <http://www.universityworldwide.edu/> dhe <http://www.universityworldwide.edu/>;


3) Përkthimin në gjuhën shqipe i dispozitave të Ligjit Grek për Avokatinë, konkretisht nga neni 1 në nenin 23 të tij.

Në zbatim të vendimit të Këshillit, janë përgatitur dhe dërguar menjëherë shkresat për informacion dhe dokumentacion drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, <http://www.universityworldwide.edu/> dhe <http://www.universityworldwide.edu/> dhe <http://www.universityworldwide.edu/> dhe <http://www.universityworldwide.edu/>, të cilët iu përgjigjën kërkesave të Këshillit si më poshtë.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka kthyer përgjigje:

me Shkresën <http://www.universityworldwide.edu/>, protokolluar në Këshill me aktin <http://www.universityworldwide.edu/> (Dokumentacioni që <http://www.universityworldwide.edu/> ka depozituar në Kuvend gjatë procesit të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë - gjithsej 238 faqe);

me Shkresën <http://www.universityworldwide.edu/>, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4723/5 prot., datë 07.10.2020 (Raporti "Mbi përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e gjyqtarëve dhe joprokurorëve" dhe Procesverbali datë 22.01.2018, ora 16:00, i Nënkomisionit për



Përzgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë - gjithsej 49 faqe).


Aktet e dërguara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, që referojnë në dokumentacionin që ka depozituar në Kuvend gjatë procesit të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, janë gjithsej 238 faqe. Nisur nga sa Këshilli ka diskutuar dhe vendosur për kryerjen e verifikimeve shtesë për kandidatin, si dokumente që mund të evidentohen janë si më poshtë:

1) Dokumenti "Vërtetim" datë 18.07.2013, në gjuhën greke, nënshkruar nga [illegjibël] dhe vulosur me Vulën Zyrtare të Universitetit Kombëtar [illegjibël]. Ky vërtetim është përkthyer në gjuhën angleze nga përkthyesi [illegjibël], noterizuar nga noteri [illegjibël], i cili ka vërtetuar firmën e përkthyesit [illegjibël]. Ky i fundit ka deklaruar se ka përkthyer dokumentin bashkëngjitur nga greqisht në anglisht dhe ka firmosur sipas rregullave. Nuk identifikohet personi që ka bërë përkthimin në gjuhën shqipe.

Në përmbajtjen e këtij dokumenti (përkthimit në gjuhën shqipe) thuhet se: "E njoh që në kohën që ai ishte student në Universitetin Kombëtar [illegjibël] pranë Fakultetit të Drejtësisë.../ Gjatë shkrimit të doktoraturës së tij (2005-2009) [illegjibël] ka qenë i punësuar pranë Fakultetit të Drejtësisë në departamentin e të drejtës publike dhe konkretisht në katedrën time akademike duke më ndihmuar mua personalisht në çdo procedurë akademike. Detyrat e tij ishin supervizimi i eseve dhe mikrotezave shkencore në nivelin Bachelor dhe Master";

2) Dokumenti datë 10.10.2013 në gjuhën angleze, lëshuar nga shtetasi [illegjibël]. Ky dokument mban nënshkrimin e personit që e ka lëshuar dhe vulë. Po ashtu, ky dokument mban edhe vulën e noterit [illegjibël]. Bashkëlidhur këtij dokumenti ndodhet Dokumenti "Vërtetim pune" në gjuhën shqipe, por nuk identifikohet personi që ka bërë përkthimin.

Në përmbajtjen e këtij dokumenti (përkthimit në gjuhën shqipe) thuhet se: "Si ka punuar nën mbikëqyrjen time si një asistent avokat nga 2.11.2003-10.08.2005. Gjatë kësaj kohe ai ka treguar aftësi të shkëlqyera si një shkencëtar dhe si një



jurist ushtrues në praktikë. Ishte një kënaqësi e madhe që nga koha e marrjes së tij në punë pas laureimit të tij, bashkëpunimi me të duke e mundësuar të tregojë aftësitë e tij akademike në praktikën reale juridike. Ai ka treguar me punën e tij se është një aset i çmuar për firmën tonë juridike duke treguar në punën e tij një dedikim dhe drejtim në çdo detyrë të caktuar prej nesh. Ai ka punuar në çështje që kanë lidhje me punët publike të cilat u zhvilluan në Athinë në 2004 siç janë çështjet e pronësisë, shitblerjes së pasurive të paluajtshme dhe çështje që lidhen me mbrojtjen e ambientit...”;

3) Dokumenti datë 07.02.2017 në gjuhën angleze, lëshuar nga shtetasi ... Ky dokument ka nënshkrimin e personit që e ka lëshuar dhe vulë. Bashkëlidhur këtij dokumenti ndodhet në gjuhën shqipe dokumenti që sipas përkthimit është lëshuar nga ...

... Ky dokument në gjuhën shqipe ka vulën e noterit Ilirjan Isaj.

Në përmbajtjen e këtij dokumenti (përkthimit në gjuhën shqipe) thuhet se: “... ka punuar me mua pranë zyrës time si një Asistent Avokat nga 05.01.2001 deri në 31.08.2003. Gjatë kësaj kohe të praktikës së tij ligjore ai ka treguar aftësi profesionale shumë të larta. Dijet e tij akademike janë të një niveli të shkëlqyeshëm. Ai është shumë i aftë, inteligjent dhe është shumë efikas në kërkimin e tij ligjor në nivel shkencor. ... ka qenë një aset i çmuar i zyrës time pasi ka qenë një individ shumë përgjegjës, bashkëpunues, i zellshëm dhe një njeri i besueshëm. Ai është marrë me çështje civile, penale dhe tregtare. Ai ka një eksperiencë të mjaftueshme në shumë detyra, por gjithashtu ai ka inteligjencën dhe aftësinë të menaxhojë situata të reja me detyra shumë të vështira...”;

4) Certifikatë datë 14 dhjetor 2014, lëshuar në nga ... në gjuhën angleze, nënshkruar dhe mban vulën e institucionit që e ka lëshuar, si dhe mban vulën e noterit ... Ky dokument përsëritet disa herë në dokumentacion, por nuk ka përkthim të tij në gjuhën shqipe, ndërsa mban vulën e noterit ... j. Referuar njësimi që noteri i ka bërë dokumentacionit në dosje, përmendet edhe “... certifikatë pjesëmarrje Universiteti ... shtator 2013-shtator 2014 ...” (faqe 200 e dokumentacionit).

Ndërsa sipas Procesverbalit datë 22.01.2018, ora 16:00, të Nënkomisionit për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të



Prokurorisë, me rend dite: 1. Votimi për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, rezulton se kandidati : është klasifikuar tek lista e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore. Konkretisht për kandidatin, në faqet 13 dhe 14 të dokumentacionit të dërguar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, është konkluduar se:

- “Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatit ka rezultuar se mungonte:
 - a. dokumentacion që vërtetonte 15 vjet eksperiencë pune si jurist;
 - b. vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi, sipas gurmës “dh”, të pikës 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016;
 - c. dokumentacioni që vërteton se nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, sipas gurmës “e” të pikës 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016;
 - d. vetëdeklarim nën përgjegjësinë e kandidatit, se nuk ka mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit, sipas gurmës “ë” të pikës 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016;
 - e. vetëdeklarim nën përgjegjësinë e kandidatit se në kohën e kandidimit nuk ka asnjë anëtar të familjes sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar, sipas gurmës “gj” të pikës 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016;
 - f. formularët e mbështetjes së edhe nga dy anëtarë të personelit akademik;
 - g. kopje e njësuar me origjinalin e pasaportës apo kartës të identitetit;
 - h. dëshmitë titujve shkencorë duhet të paraqiten të njësuar me origjinalin.

Në përgjigje të shkresës : , 17 të Sekretarit të Përgjithshëm, për plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit, kandidati ka paraqitur dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor 5 ditor për plotësimin e dokumentacionit.

Në vazhdim të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, sipas kushteve ligjore të renditura në pikën 2 të nenit 134 të ligjit 115/2016, rezulton se kandidati;

- a) është shtetas shqiptar; b) nuk rezulton të ketë 15 vjet përvojë pune në profesionin si jurist, për arsye se është diplomuar në datë 3.2.2004, pranë Universitetit të



..., fakt i cili vërtetohet edhe nga njësimi i diplomës së bërë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës; c) në kohën e kandidimit, rezultojnë të jetë pedagog me kohë të plotë në disa fakultete drejtësisë, jo më pak se 5 vjet (prej vitit 2009 e në vijim); ç) është personel akademik i kategorisë “profesor”; d) në kohën e kandidimit nuk rezultojnë të jetë rektor ose Drejtor i Shkollës së Magjistraturës; dh) rezultojnë se nuk ka masë disiplinore në fuqi; e) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; ë) nuk ka mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti të politike përpara kandidimit; f) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptim të ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”; g) nuk rezultojnë të ketë qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës; gj) në kohën e kandidimit, nuk rezultojnë të ketë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe të afërm të shkallës së parë që është kandidat për në Këshill.

Bazuar në verifikimin e parashtruar më sipër, kandidati ... nuk kualifikohet për këtë pozicion, pasi gjendet në kushtet e mospërmbushjes së kushtit ligjor të parashikuar nga neni 134, pika 2, germa “b” e ligjit nr. 115/2016”.

... ka kthyer përgjigje me Shkresën e datës 06.10.2020, protokolluar në Këshill me aktin ... nga përmbajtja e së cilës rezultojnë se: “... nuk ka qenë ndonjëherë anëtar i partisë ... e ... , nuk ka konkurruar ndonjëherë dhe nuk ka qenë i zgjedhur në pozicione drejtuese të partisë ... dhe nuk ka marrë pjesë asnjëherë në garat elektorale për zgjedhjet politike apo në zgjedhjet vendor në Republikën e Shqipërisë”;

Partia ... ka kthyer përgjigje me Shkresën ... , protokolluar në Këshill me aktin ... nga përmbajtja e së cilës rezultojnë se: “... nuk figurojnë në “database”-in e partisë si anëtar dhe as si i zgjedhur në organet drejtuese vendore e qendrore të ... për periudhën 26.09.2009-26.09.2019”;

Së fundi, është administruar edhe përkthimi në gjuhën shqipe, i dispozitave të Ligjit grek nr. 4194 “Kodi i Avokatisë”, nenet 1 deri në 23. Përkthimi në gjuhën shqipe



është bërë nga përkthyesi zyrtar , protokolluar në Këshill me aktin nr.

Në përfundim të parashtrimit të relacionit shtesë nga zoti Toska, anëtarët e Këshillit fillojnë diskutimet në lidhje me çështjen.

E merr fjalën *zonja Shehu* fillimisht e cila i referohet procesverbalit të datës 16.01.2020 ku Këshilli ka vendosur që t'i kërkohet kandidatit plotësimi i dokumentacionit në lidhje me: Konfirmimin nga dhoma e avokatisë greke në lidhje me ushtrimin e avokatisë nga ana e kandidatit në Greqi; Përkthimin e ligjit grek; Konfirmimin nga universiteti grek në lidhje me veprimtarinë e tij asistent pedagog; Konfirmimin nga universiteti në Zvicër.

Nga relacioni shtesë, rezulton se kandidati ka paraqitur një vërtetim të lëshuar nga ku vërtetohet që ushtron profesionin e avokatit.

Më tej *zonja Shehu* i drejton një pyetje relatorit “A ka një dokument nga Dhoma e Avokatisë që të vërtetojë regjistrimin e kandidatit pranë kësaj dhome, për ushtrimin e profesionit Asistent Avokat?” – duke iu referuar kështu përkthimit të Kodit Grek të Avokatisë (kërkesë kjo nga disa anëtarë), Kapitulli 2 “Fitimi i titullit të avokatit – Stazhi – Provimi”, Seksioni A - “Stazhi”, pika 4 thuhet që: “4. Stazhi fillon me regjistrimin e kandidatit në regjistrin e veçantë të asistentëve të Dhomës së Avokatisë të vendit ku do të kryejë stazhi.”

Lidhur me këtë pyetje, *zoti Toska* shprehet se dokumentat që kandidati ka paraqitur janë dokumentat të cilat janë listuar në relacionin shtesë dhe nuk ka asnjë dokument tjetër përveç tyre.

Në vijim, *zonja Shehu* shprehet se vërtetimi i paraqitur nga kandidati, i jep përgjigje pyetjes së parë drejtuar atij, pra konfirmim nga autoriteti kompetent i Republikës së Greqisë për ushtrimin e profesionit të avokatit të , ndërkohë që pyetja e dytë nuk merr përgjigje nga ky vërtetim ndaj dhe *zonja Shehu* vlerëson se duhet marrë një konfirmim nga kandidati ose nga organi kompetent, pasi



mbase kandidati mund të mos e ketë kuptuar drejt atë që i është kërkuar. Ky është një moment i paqartë për zonjën Shehu, në lidhje me situatën e kandidatit, ndaj edhe vlerëson që kandidatit t'i jepet mundësi që ta paraqesë këtë vërtetim.

Sipas *zotit Toska*, kandidatit i janë listuar të gjitha çështjet që janë konsideruar në mbledhjen plenare dhe kandidati ka sjellë ato dokumenta që ai ka konsideruar. Pyetjet/çështjet kanë qenë të qarta.

(Anëtarët e Këshillit konsultohen një moment me procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 16.01.2020.)

Merr fjalën më tej *zonja Ukeperaj* e cila lexon një pjesë nga procesverbali i datës 16.01.2020, ku zoti Toska është shprehur se: “Atëherë, nga të gjithë debatet që ndoqa deri tani mes kolegëve, kam evidentuar disa momente ku nga anëtarë është konsideruar që do duhet të marrim disa konfirmime në mënyrë tjetër apo shtesë. Një nga ato ishte konfirmimi nga Dhoma e Avokatisë në lidhje me ushtrimin e shërbimit të avokatisë pranë avokatit që përmendi relatori.”

Mbi sa më sipër *Zoti Toska* shprehet se duket sikur ka ndonjë konfondim apo sikur pyetjet/çështjet e bëra nga relatori, z.Toro nuk janë në përputhje me atë që ka thënë Këshilli. Në fakt pyetjet janë të gjitha brenda çështjeve të shqyrtuara në Këshill. Kërkesa e dytë e bërë nga relatori, është çështja e parë e ngritur në mbledhjen plenare të datës 16.01.2020.

Zoti Hallunaj ndërhyr një moment për të shprehur se konfirmimi duhej nga autoriteti kompetent i Republikës.

Në lidhje me ndërhyrjen e zotit Hallunaj, *zoti Toska* shprehet se relatori, z.Toro, për të mos bërë ndonjë gabim, është shprehur “autoriteti kompetent”, autoritet të cilin, ai që e njih ligjin grek, e di se kush është. Në atë kohë Këshilli ende nuk ishte njohur me

permbajtjen e ligjit grek te avokatisë. Ndaj edhe relatori nuk e ka specifikuar organin qe duhet te lëshonte konfirmimin perkatës.

Më tej *Zoti Qoku* merr fjalën për të shtuar qe sistemi grek është i tillë qe nëse një zyrë avokatie është e regjistruar në regjistrë, përgjegjësi për asistentët avokatë e mban ai qe është shëf i zyrës, në rastin konkret profesori. Ndaj atë qe Këshilli ka kërkuar, e ka marrë, - sipas mendimit të zotit Qoku. Këshilli duhet të çmojë nëse është apo s'është kjo gjë. Ai nuk është avokat i regjistruar në Dhomë. Zyra e avokatisë mban përgjegjësi për asistentët e vet duke i deklaruar ato kudo.

Zonja Llagami bën një ndërhyrje duke rikujtuar anëtarët qe nga seanca e sotshme, me kërkesë të znj. Ukperaj, ligji është i përkthyer i plotë nga Këshilli dhe jo më nga pala.

Zoti Qoku rithekson faktin qe kandidati nuk është avokat dhe ky është fakt i ditur. Kandidati është i regjistruar në zyrën avokatore të profesorit dhe profesori është i regjistruar në dhomën perkatëse ku ushtron profesionin. Ndaj në opinionin e tij zoti Qoku është i mendimit qe mos të zgjatet më Këshilli duke kërkuar mbi këtë vërtetim, pasi kandidati nuk e ka.

Pas këtyre diskutimeve, *zoti Toska* merr fjalën dhe parashton shkurtimisht opinionin e tij rreth përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të kandidimit për në Gjykatën e Lartë, nga ana e kandidatit :

“Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 136, pika 3 dhe 4 përcakton se:

“3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët qe përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi”. “4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike,

gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteria të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj”.

Kushti i kandidimit për pasjen jo më pak se 15 vjet përvojë si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës, si dhe mbajtja gradë shkencore në drejtësi, përcaktohet edhe në pikën 1, të nenit 49, të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ndërkohë, në këtë dispozitë të ligjit, përcaktohen edhe kriteria të tjera për kandidimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

Pra, si kusht parësor për kandidimin në Gjykatën e Lartë përcaktohet përvoja profesionale, në masën dhe llojin e saj.

Duke ardhur në rastin e kandidatit, në relacionin përkatës për rezultatet e verifikimit, përgatitur nga relatori i mëparshëm z.Toro, që ka qenë objekt shqyrtimi nga Këshilli në Mbledhjen e datës 16.01.2020, ndër të tjera, është evidentuar dhe përvoja profesionale e kandidatit, për periudhën përpara kandidimit, pra përpara datës 26.09.2019. Përvoja e kandidatit në atë rast është paraqitur edhe në formë tabelare, si më poshtë:

Për periudhën tetor 2003 – nëntor 2005 ka punuar në Zyrë avokatie
– 26 muaj;

Për periudhën dhjetor 2005 – shtator 2009 ka punuar Asistent pedagog, Athinë-Greqi – 46 muaj;

Për periudhën tetor 2009 – gusht 2013 ka punuar Pedagog Universiteti
– 47 muaj;

Për periudhën shtator 2013 – shtator 2014 ka punuar Kërkues Shkencor, Univ i
– 13 muaj;

Për periudhën tetor 2014 – tetor 2015 ka punuar Dekan i Fakultetit të Drejtësisë,
– 13 muaj;

Për periudhë tetor 2015 – 29 mars 2018 ka punuar Universiteti
– 29 muaj;

Për periudhën 30 mars 2018 – nëntor 2019 Komisioner Publik – 19 muaj;

Për një total 193 muaj (16 vite) punë.



Sa i përket përvojës profesionale për periudhën Tetor 2003-Nëntor 2005, në Zyrën e Avokatit ... , pra 26, muaj, në jetëshkrimin e depozituar nga kandidati ... , kjo përvojë profesionale evidentohet si “asistent avokat”.

Në rastin e kandidimit, në lidhje me këtë përvojë, kandidati ka depozituar një letër të ... , që mban datën 07.02.2017, që është në gjuhën angleze, shoqëruar me përkthimin në shqip , në të cilin, ndër të tjera, parashtrohet: “... ka punuar me mua pranë zyrës time si Jurist nga 01.10.2003 deri në 30.11.2005, Gjatë kësaj kohe të praktikës së tij ligjore ai ka treguar aftësi shumë të larta. ... Ai është marrë me çështje të së drejtës civile dhe administrative. ...”.

Relatori i mëparshëm i çështjes, në kuadër të verifikimit të kësaj të dhëne, ka patur një komunikim elektronik me Ky i fundit, me e-mailin e datës 15.10.2019, në gjuhën angleze, ndër të tjera ka parashtruar se: “... Siç kam vërtetuar në letrën time që është lëshuar sipas kërkesës së ... , ai ka punuar për mua në zyrën time juridike si legal officer/zyrtar ligjor (2003-2005). / Gjatë këtyre dy viteve ai më ka ndihmuar shumë në shumë raste në të drejtën civile dhe administrative. ... / Ndaj tij nuk u dhanë asnjëherë masa disiplinore.”.

Mbi të dhënat e këtyre dy dokumenteve, verifikimi i përvojës profesionale të kandidatit ... , për periudhën tetor 2003 - nëntor 2005, është konsideruar i mjaftueshëm për të nxjerrë përfundime për pasjen dhe llojin e saj. Në këtë rast, sipas vlerësimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ndërsa ishte rasti i parë, Këshilli do të duhej të diskutonte nëse përvoja si “asistent avokat” barazohej me atë si “avokat”, që kërkon Kushtetuta dhe ligji si kusht kandidimi për në Gjykatën e Lartë.

Këshilli, në mbledhjen e datës 16.01.2020, konsideroi bërjen e verifikime shtesë, përfshirë edhe për përvojën e kandidatit për periudhën tetor 2003 - nëntor 2005.

Si dhe më përpara parashtrova, Këshilli ka vendosur që kandidatit ... t'i kërkohej plotësimi i dokumentacionit si vijon:

- 1) Konfirmimi nga Dhoma e Avokatisë greke në lidhje me ushtrimin e shërbimit të avokatisë pranë avokatit në Greqi;
- 2) Përkthimi i ligjit grek për të kuptuar meqenëse mund të vihet në diskutim interpretimi i qenies së kandidatit asistent avokat dhe a mund të konsiderohet avokat në kuptim të ligjit shqiptar.



Në respektim të vendimit të Këshillit, relatorit të çështjes, në rrugë elektronike, më datë 17.01.2020, njoftoi kandidatin [] për plotësimin e dokumentacionit në lidhje me kushtet dhe kriteret e kandidimit, ndër të tjera edhe me:

1. Konfirmim nga autoriteti kompetent i Republikës së Greqisë për ushtrimin e profesionit të avokatit të [], si dhe për kohën e ushtrimit nga ai të këtij profesioni.

2. Konfirmim nga autoriteti kompetent i Republikës së Greqisë për llojin e aktivitetit të kandidatit pranë Zyrës së Avokatit [], si dhe për kohën e këtij aktiviteti.

3. Konfirmim nga Zyra e Avokatit [] për aktivitetet konkrete të kryera nga kandidati pranë kësaj zyre, si dhe nëse ato janë kryer ose jo kundrejt pagesës.

Në përmbushje të kërkesës së Këshillit, si dhe me përpara parashtrova, sa i përket përvojës profesionale për periudhën Tetor 2003 - Nëntor 2005, kandidati [] depozitoi:

1) Dokumentin "Vërtetim" datë 27.01.2020, lëshuar nga [] në të cilin, sipas përkthimit në gjuhën shqipe, thuhet se: "... siç rezulton nga regjistrat e [] është anëtar i [], i regjistruar me [] i sipërcituari ende mbetet i regjistruar në Regjistrat e Dhomës së Avokatisë...";

2) Dokumentin "Vërtetim" datë 05.02.2020, lëshuar nga [] drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin, sipas përkthimit në gjuhën shqipe, ndër të tjera, thuhet se: "... ka qenë i punësuar në Zyrën time të Avokatisë nga 1.10.2003 deri më 30.11.2005 në pozicionin/cilësinë e Legal Officer. Gjatë kësaj periudhe [], si i diplomuar prej Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit Kombëtar dhe Kapodistrian i [] më 2003, u punësua në Zyrën time dhe ofroi shërbime asistent avokati, duke ndihmuar në trajtimin gjyqësor dhe jashtëgjyqësor të çështjeve juridike gjithashtu edhe në ofrimin e këshillimeve juridike për persona fizike dhe ligjorë./ Në kontekstin e bashkëpunimit tonë ai bënte kërkime në legjislacione vendimeve gjyqësore dhe përgatiste fashikujt gjyqësor për mbrojtjen e çështjeve nëpër Gjykata. Gjithashtu, hartonte drafte të Padive në Gjykatat



Civile dhe ato Administrative, drafte për kontrata civile dhe tregtare si dhe dokumente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative me Shtetin Grek dhe Autoritetet Administrative Greke./ Konkretisht është paraqitur me autorizim nga mua si asistent avokat ose me autorizim nga të përfaqësuarit e Zyrës time në Gjykata e Krimeve të Lehta dhe në Gjykatat e Pajtimit si edhe pranë Autoriteteve Administrative dhe Shërbimeve Publike për të kryer çështjet e Zyrës time të Avokatisë. Jemi bashkë paraqitur në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe të Dytë për gjyqe të ndryshme, për të cilat ka kontribuar edhe në përpunimin ligjor dhe në dhënien e këshillave për trajtimin e këtyre çështjeve gjyqësore, si anëtar i Zyrës time ...”.

Ndërkohë, po për përvojën profesionale për periudhën Tetor 2003 - Nëntor 2005, në respektim të vendimit të Këshillit në mbledhjen e datës 28.09.2020, në kuadër të verifikimit u administrua, nga Kuvendi i Shqipërisë, dokumentacioni i kandidimit të ... , në vitin 2017, për zgjedhjen e anëtarëve të KLGJ/KLP.

Si dhe më përpara parashtrova, në rastin e atij kandidimi, ... ka dorëzuar edhe Dokumentin datë 10.10.2013, në gjuhën angleze, lëshuar nga shtetasi ... , në të cilin gjendet nënshkrimi i këtij të fundit dhe vula. Dokumenti është i noterizuar nga Noteri ... , ndërsa bashkëlidhur atij gjendet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe, por nuk identifikohet personi që ka bërë përkthimin. Në përmbajtjen e këtij dokumenti, përkthimit në gjuhën shqipe, ndër të tjera, thuhet se: ... ka punuar nën mbikëqyrjen time si një asistent avokat nga 2.11.2003-10.08.2005. Gjatë kësaj kohe ai ka treguar aftësi të shkëlqyera si një shkencëtar dhe si një jurist ushtrues në praktikë. ... Ai ka punuar në çështje që kanë lidhje me punët publike të cilat u zhvilluan në Athinë në 2004 siç janë çështjet e pronësisë, shitblerjes së pasurive të paluajtshme dhe çështje që lidhen me mbrojtjen e ambientit...”;

Së fundi, po për përvojën profesionale për periudhën Tetor 2003 - Nëntor 2005, në respektim të vendimit të Këshillit në mbledhjen e datës 28.09.2020, në kuadër të verifikimit u administrua edhe përkthimi në gjuhën shqipe, bërë me kërkesë të Këshillit, nga përkthyesja zyrtare ... , i Ligjit grek nr. 4194 “Kodi i Avokatisë”, nenet 1 deri në 23, të cilat përmbajnë dispozita në lidhje me profesionin e avokatit, ndërsa në Kapitullin II, nenet 10 e vijues rregullohet fitimi i titullit të avokatit, ku gjenden dispozita për asistent avokatin.



Sipas nenit 10 të këtij ligji, për të marrë statusin e asistent avokatit, i diplomuari për drejtësi duhet të paraqes kërkesë për regjistrim si i tillë përpara Kryetarit të Dhomës së Avokatisë së zonës në të cilën ai dëshiron të bëj stazhin (1), ndërsa sipas pikës 4 të këtij neni, "Stazhi fillon me regjistrimin e kandidatit në regjistrin e veçantë të asistentëve të dhomës përkatëse të avokatisë. Statusi i asistentit ruhet për atë kohë sa kërkohet për përfundimin e stazhit dhe pjesëmarrjen e tij të suksesshme në provimet kualifikuese dhe deri në emërimin e tij si avokat".

Ndërkohë, sipas nenit 11 të ligjit grek të avokatisë, asistent avokati duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e statusit të avokatit (1) dhe se pengesat dhe papajtueshmëritë e përcaktuara për avokatin, vlejnë edhe për asistent avokatin (2), i cili i nënshtrohet ligjit disiplinor dhe ndaj tij mund të jepen dënime disiplinore si për avokatin, ndër to dhe rregjistrimi nga regjistri i asistentëve ose zgjatja e kohës së stazhit deri në dy vjet (3).

Më tej, në nenin 6 të ligjit grek të avokatisë, rregullohen kërkesat ligjore dhe pengesat për të qenë avokat. Konkretisht, ndër të tjera, në këtë dispozitë përcaktohet se: "Avokati duhet: 1. Të jetë shtetas grek ose shtetas i një vendi anëtar të Bashkimit Europian ose i një shteti tjetër, i cili është pale në Konventën për Zonën Ekonomike Europiane. Një grek me origjinë, mund të emërohet avokat me lejen e Ministrit të Drejtësisë, lëshuar pas mendimit të dhomës përkatëse të avokatisë. 2) Të jetë mbajtës i diplomës së Departamentit Juridik të Fakultetit të Drejtësisë të një Institucioni të Arsimit të Lartë në Greqi ose një diplome ekuivalente dhe përkatës nga një shtet tjetër, me kusht që të jetë njohur në përputhje me procedurat ligjore. 3. Të mos jetë dënuar në mënyrë të paravokueshme: ... 4. Të mos jetë privuar në mënyrë të pakthyeshme nga të drejtat civile. ... 5. Të mos jetë vendosur në mbrojtje gjyqësore të plotë ose të pjesshme, ... 6. Të mos ketë statusin e klerikut apo të murgut".

Ndërsa, në nenin 13 të ligjit grek të avokatisë rregullohet "Kohëzgjatja e stazhit-Përmbajtja", ku në pikën 1 të tij përcaktohet se: "1. Stazhi zgjat tetëmbëdhjetë (18) muaj".

Së fundi, në nenin 12 të ligjit grek të avokatisë rregullohen "Të drejtat e paraqitjes të asistent avokatit", duke u përcaktuar se: "1. Asistent avokati mund të paraqitet në gjykatat penale, autoritetet e procedurës paraprake, gjykatat e paqit në shqyrtimin e kundërvajtjeve penale, në marrjen e deklarimeve me betim, si dhe para çdo autoriteti



administrative. 2. Asistent avokati mund të paraqitet së bashku me avokatin tek i cili bën stazhin dhe të nënshkruajë parashtrime, shënime dhe memorandum, në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë”.

Thënë sa më lart, Këshilli sot do të duhet të diskutojë atë çka dhe me parë është ngritur si çështje, pra për pasjen nga kandidati të përvojës së “avoktit” për periudhën Tetor 2003 - Nëntor 2005, sikundër Kushtetuta dhe ligji kërkon, në rrethanat kur prej kandidatit përvoja e kësaj periudhe është paraqitur si “asistent avokat”. Dhe përveç kësaj, tashmë Këshilli do të duhet të diskutojë edhe për pasjen nga kandidati të përvojës si “asistent avokat”, për sa kohë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk rezulton që kandidati, për këtë periudhë, të ketë qenë i regjistruar në regjistrin e posaçëm të asistentëve të një prej dhomave të avokatisë në Greqi, sikurse ligji grek kërkon për marrjen e statusit të “asistent avoktit”. Vlen të përmendet se nuk ka dorëzuar ndonjë dokument që të konfirmojë këtë fakt, ashtu sikundër edhe dokumentet e dorëzuar prej tij nuk sjellin ndonjë të dhënë konkrete në këtë drejtim. Plotësimi i kërkesave për marrjen e statusit të asistent avoktit është një çështje për të cilën ligji grek ka ngarkuar një autoritet të caktuar vendas (Kryetarin e dhomës së avokatisë ku kandidatë dëshiron të kryejë stazhin), ndërsa fitimi i këtij statusi vërtetohet nëpërmjet regjistrimit në regjistrin e posaçëm të asistentëve të dhomës përkatës të avokatisë, ndërkohë që ligji përcakton edhe kohëzgjatjen maksimale të stazhit, pra të mbajtjes së statusit të “asistent avoktit”.

Në vlerësimin tim, të dy situatat që rezultojnë, pra mosvërtetimi në mënyrë të plotë dhe të qartë, në përputhje me ligjin, të pasjes së statusit të “asistent avoktit” për periudhën Tetor 2003 - Nëntor 2005, pra 26 muaj, si dhe mosvërtetimi i pasjes së përvojës së “avoktit” për këtë periudhë, sikurse Kushtetuta dhe ligji kërkon, janë rrethana që potencialisht mund të passjellin ndalimin/skualifikimin e kandidatit nga kandidimi për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur deri në momentin e kandidimit, duke përfshirë edhe përvojën për këtë periudhë, rezulton që ai në total të ketë 15 vjet e 11 muaj përvojë profesionale.

Prandaj, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të të drejtës për t’u dëgjuar të subjektit në një procedure administrative, si dhe në zbatim të pikës 11, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit nr.75, datë 23.05.2019, “Për



procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i propozoj Këshillit që të vendosë njoftimin e kandidatit për dy rrethanat/gjetjet e rezultuara nga verifikimi, si dhe për motivet të cilat potencialisht mund të passsjellin ndalimin e kandidimit të tij, duke i dhënë atij mundësinë për të dhënë shpjegime rreth tyre, sikundër edhe për të paraqitur prova nëse e çmon të nevojshme.”

Anëtarët e Këshillit, pas parashtrimeve të zotit Toska, diskutojnë mbi përvojën e kandidatit si asistent avokat, për shkak se kjo çështje nuk është e sqaruar në mënyrë të ezauruar edhe për faktin se në Kushtetutë thuhet përvoja si “avokat” dhe jo si “asistent avokat”. Gjithashtu ndër të tjera diskutohet edhe fakti nëse kandidati duhet t’i referohet fakti që ka gjetje, pasi gjetja është konstatim i një problemi si dhe mund të referojë paragjykim ndaj rastit në fjalë. Ndaj disa nga anëtarët janë të mendimit që mos t’i komunikohen si gjetje por thjesht kandidati të ftohet të japë shpjegimet e tij mbi periudhën që pretendon se ka punuar “asistent avokat”, si dhe ku bazohet dhe si arsyetohet mbi përfshirjen e kësaj përvoje në ato përvoja që Kushtetuta në mënyrë shprehur kërkon për emërimin në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur.

Gjatë diskutimeve zoti Hallunaj ndërhyr për të shprehur mendimin e tij lidhur me procesin ku sipas tij shumë gjëra nuk janë relatuar saktë nga relatori i mëparshëm.

Lidhur me këtë fakt, zoti Toska shprehet se faktet janë relatuar tërësisht, ndërsa vlerësimi i tyre është individual.

Në vijim, nisur nga rrethanat e rezultuara gjatë verifikimit, anëtarët bien dakord që kandidati t’i komunikohen dy gjetjet e procedurës së verifikimit dhe konkretisht: - në lidhje me faktin e pasjes nga kandidati të përvojës profesionale si “asistent avokat”, për periudhën Tetor 2003 - Nëntor 2005, në rrethanat kur, sipas ligjit grek të avokatisë “asistent avokati” regjistrohet në regjistrin e posaçëm të asistentëve të një prej dhomave të avokatisë, ndërkoqë që kandidati nuk ka depozituar ndonjë dokument që vërteton një fakt të tillë; - në lidhje me faktin e pasjes nga kandidati, për periudhën Tetor 2003 - Nëntor 2005, të një prej përvojave profesionale të kërkuara nga Kushtetuta

dhe ligji, pra si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës, ndërsa nga ana tjetër, përvoja profesionale e kësaj periudhe është evidentuar si “asistent avokat”.

Anëtarët bien dakort që kandidatit t’i lihet një afat deri në 5 ditë për paraqitjen e shpjegimeve rreth gjetjeve të procedurës së verifikimit.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Kryetare
NAUREDA ILLIAGAMI

Zëvendëskryetar
MAKSIM QOKU

Anëtar
MEDI BICI

Anëtar
ILIR TOSKA

Anëtare
BRIKENA UKPERAJ

Anëtare
BRUNEDA KADI

Anëtare
MARÇELA SHEHU

Anëtar
ERJON MUHARREMAJ

Anëtar
DRITAN HALLUNAJ

Mbajtur, Specialiste
Rosalba Xhabrahimi

